Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/228
Datë: 07.06.2021

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 31.05.2021 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet** Universiteti "Haxhi Zeka", Fakulteti i Agrobiznesit, me adresë Rr. "UÇK" 30000 Pejë, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 31.05.2021 deri 30.05.2024, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

    1.1. **Prodhuesit e kulturave të përziera dhe të kafshëve,** Niveli IV sipas KKK me 60 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit deri në pesëmbëdhjetë (15) kandidatë brenda një cikli/grupi apo brenda vitit të jenë dy grupe me nga 15 kandidatë.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së Universitetit "Haxhi Zeka", për akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, si dhe Raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Universitetit "Haxhi Zeka";
2. Arkivit të AKK.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK